



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery	13.06.2022	viti god year	2
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojra Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SEPRISHCK	3448/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.213/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2815/19 të datës 10.06.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A/02/06/2017 të datës 10.01.2017 të parashtruar nga ankuesja me adresë

Prishtinë, kundër Vendimit me numër protokollit 04-052-615 të datës 30.12.2016 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në çështjen juridike "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim më datën 13.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës *Shpallet jo kompetent*, për të vendosur lidhur me ankesën me numër A/02/06/2017 të datës 10.01.2017, të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja më datë 10.01.2017 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 58/2017 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr. 04-052-615 të datës 30.12.2016 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe Vendimit me Nr.04-052-578 të datës 07.12.2016 të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, zbatim të gabuar të bazës ligjore dhe shkeljeve esenciale të ligjit material.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 58/2017 e datës 10.01.2017 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 04-052-616 të datës 30.12.2016 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës; Konkursin e datës 17.10.2009 nga Enti i Statistikave të Kosovës për Zyrtar Financiar; Urdhër Përmbarimi i datës 19.11.2013; Aktvendim E.nr.1235/2013 i datës 18.11.2013 i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Vendimin Nr 02 (267) 2013 i datës 30.08.2013 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimi i datës 22.11.2013 për ankuesen; Certifikatën e datës 14.04.2009 për ankuesen; Vendimin A 02/473/2016 i datës 29.11.2016 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.1301/2013 i datës 07.10.2016 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigje në ankesë e datës 17.01.2017; Vendimin me Nr.04-052-578 i datës 07.12.2016 i Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës; Kontratë Konsulente Nr.34-12/10 e datës 01.12.2010; Kontratë Konsulente Nr.10-05/13 e datës 02.05.2013; Kontratë Konsulente Nr.10-02/13 e datës 01.02.2013; Kontratë Konsulente Nr. 10-09/13 e datës 02.09.2013; Kontratë Konsulente Nr. 34-12/11 e datës 31.12.2011; Vendimin A/02/06/2017 i datës 14.02.2017 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.2815/19 të datës 10.06.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimit AA.nr.467/2020 të datës 04.04.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimin ARJ-UZVP.nr.26/2018 i datës 22.03.2018 i Gjykatës Supreme të Kosovës; Ankesën e datës 10.07.2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktvendimin AA.nr.1/2019 i datës 05.11.2019 i Gjykatës së Apelit të Kosovës; Procesverbal mbi shqyrtimin kryesie A.nr.2814/19; Aktgjykim A.nr.2036/16 i datës 13.02.2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimi A.nr.363/17 i datës 17.10.2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.2815/19 të datës 10.06.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, konstatoi së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja

SEPSE:

Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesja sipas Kontratës së Punës me numër 128-05/10-MAP-ESK të datës 14.01.2010 ka themeluar marrëdhënie të punës në Entin e Statistikave të Kosovës tani Agjencia e Statistikave të Kosovës, në pozitën "Zyrtar Financiar" në kohëzgjatje prej 05.01.2009 deri më datë 31.12.2010.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesja me datë 01.10.2010 me institucionin e njëjtë punëdhënës ka lidhur Kontratë Konsulente Nr.34-12/10 në kohëzgjatje nga data 01.10.2010 deri më datë 31.12.2011 në funksionin e *Zyrtares së Personelit*, duke vazhduar me tej këtë funksion të konsulences deri me datë 31.12.2011 sipas Kontratës Nr. 34-12/2010 të datës 01.12.2010.

Ankuesja serish më datë 31.12.2011 ka lidhur Kontratë Konsulente Nr.34-12/11 me Entin e Statistikave të Kosovës tani në funksion të *Udhëheqëses së Personelit* të ZRP në kohëzgjatje prej datës 04.01.2011 deri më datë 31.12.2013 sipas Kontratës Nr. 10-02/13 të datës 01.02.2013, Nr.10-05/13 të datës 02.05.2013 dhe Nr.10-09/13 të datës 02.09.2013.

Ankuesja më datë 30.05.2013 i është drejtuar me kërkesë Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Ankesave në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, për sistemin e saj sipas Kontratës 128-05/10-MAP-ESK të datës 14.01.2010 mirëpo e njëjta për shkak të heshtjes se këtij të fundi, më datë 01.07.2013 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili me Vendimin Nr.02 (267) 2013 të datës 30.08.2013 ka detyruar organin e punësimit që ta kthejë ankuesen në pozitën Zyrtare Financiare. Kundër Vendimit të Këshillit Nr.02 (267) 2013 të datës 30.08.2013, Agjencia e Statistikave të Kosovës ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa Gjykata me Aktgjykimin A.nr.1301/2013 të datës 07.10.2016 ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses duke e anuluar Vendimin e Këshillit dhe lëndën e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke vepruar sipas Aktgjykimit A.nr.1301/2013 të datës 07.10.2016, me Vendimin A 02/473/ është shpallur jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankueses. Kundër këtij vendimi ankuesja ka parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa kjo e fundit me Aktgjykimin A.nr.2036/16 të datës 13.02.2018 ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses i cili aktgjykim edhe është vërtetuar nga Gjykata e Apelit me Aktgjykimin AA.nr.175/2018.

Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës bazuar në Aktgjykim A.nr.1301/2013 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Vendimit A 02/473/2016 të Këshillit i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit Nr.04-052-578 të datës 07.12.2016 ka ndërprerë marrëdhënien e punës së ankueses. Ankuesja kundër këtij vendimi, ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, i cili me Vendimin me numër protokollit Nr. 04-052-615 më datë 30.12.2016 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses. Ankuesja kundër vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, serish parashtron ankesë më datë 10.01.2017 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke vendosur sipas ankesës së datës 10.01.2017, me Vendim A/02/06/2017 datë 14.02.2017 është shpallur jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankueses. Ankuesja kundër këtij vendimi ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 10.06.2020 ka nxjerrë Aktgjykimin A.nr.2814/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke e anuluar Vendimin A/02/06/2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje dhe rishqyrtim. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 10.07.2020 ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit e Kosovës kundër Aktgjykimit A.nr.2814/19. Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative më datë 04.04.2022 ka nxjerrë Aktgjykim AA.nr.467/2020 me të cilin ka refuzuar ankesën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke e vërtetuar Aktgjykimin A.nr.2814/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me arsyetimin që Vendimin A/02/06/2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është arsyetuar në mënyrë të duhur.

Kolegji lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore si dhe bazuar në provat materiale ka konstatuar se ankuesja fillimisht me datë 05.01.2009 kishte themeluar marrëdhënie të punës me Entin e Statistikave të Kosovës, në kohën kur ishte në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil, përkatësisht në kohëzgjatje prej 05.01.2009 deri më datë 31.12.2010, ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se ankueses i është bërë zëvendësimi i Kontratës së punës Nr. 128-05/10-MAP-ESK të datës 14.01.2010 me akt Emërim të përhershëm ashtu siç përcaktohej me nenin 96 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i aplikueshëm nga data 09.07.2010.

Me tej, Kolegji nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesja pa ndonjë veprim juridik-administrativ lidhur me definimin e statusit të shërbyesit civil, po me institucionin e njëjtë punëdhënës krijon marrëdhënie të punës mbi bazën e kontratës së konsulences, duke filluar nga data 01.10.2010 deri me datë 21.12.2013, dhe rrjedhimisht nisur nga këto fakte, Kolegji vlerëson se ankuesja me vet krijimin e marrëdhënies së punës se konsulencës, konsiderohet se në mënyrë të heshtur është dorëhequr nga marrëdhënia e punës të themeluar me datë 05.09.2009.

Kolegji në kuptim të shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar me ankesë ju referua dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 12 paragrafi 1 me të cilin përcaktohej se: *Në Shërbimin Civil të Kosovës ekzistojnë dy kategori të punësuarve: 1.1. pozitat e nëpunësve civilë të karrierës - të cilët ushtrojnë funksionet në baza të përhershme për arritjen e objektivave të përgjithshme institucionale; dhe 1.2. pozitat e nëpunësve civilë të jo karrierës - të cilët ushtrojnë funksionet me kohëzgjatje të kufizuar deri në dy (2) vjet, për zbatimin e projekteve të caktuara, zëvendësimi i përkohshëm i nëpunësve të përhershëm civilë dhe në raste të mbingarkesave në punë,* andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se kategoria e të punësuarave me kontrata konsulente nuk bënë pjesë në asnjërën nga kategoritë e të punësuarve në shërbimin civil të Kosovës respektivisht ankuesja në cilësinë e punëmarrësit/konsulentit nuk ka statusin e nëpunësit civil, kështu që, nisur nga ky konstatim si dhe duke u bazuar në autorizimet ligjore të Këshillit sipas Ligjit Nr.03/L-192 dhe Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbim Civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A/02/06/2017 të datës 10.01.2017 të parashtruar nga ankuesja

Lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave mori parasysh edhe Aktgjykimin ARJ-UZVP.Nr.26/2018 të datës 22.03.2018 të Gjykatës Supreme të Kosovës për rastin e ankuesit V.B. me të cilin është konstatuar se *..”kjo gjykatë pranoi konstatimin e gjykatave të instancave më të ultë se organi i paditur drejtë ka vepruar, kur ka shpallur veten jokompetent për shqyrtimin e ankesës së paditësit, nga fakti se kategoria e punësuarave me kontrata konsulentë në shërbim civil nuk bëjnë pjesë në dy kategoritë e të punësuarave në shërbimin civil të Kosovës. Sipas vlerësimi të kësaj Gjykate, të pabazuar janë thëniet e paditësit lidhur me shkeljet, sepse i vlerësoi të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë, ngase aktgjykimin gordinuar është i qartë dhe i kuptueshëm, përmban arsye të mjaftueshme dhe faktet vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme. Po ashtu kjo Gjykatë vlerëson se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit dhe është bërë aplikimi i drejtë i të drejtë materiale”.*

Bazuar si me lart, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A nr.213/2020

Avdyll BEKTESHI

Avdyll Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI
Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovë ;
- Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

